



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikës dhe Financa, e mbajtur më 23.04.2018,
duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Genc Sherifi, Vala Peshku, Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Visare Gashi, Fadil Gashi dhe Sami Boroci.

Mungoi: Blerand Stavileci.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Jonuz Salihaj, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Faton Ajeti, nga OSBE-ja, dhe Admir Shala nga INPO. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Agim Kuleta, kryesues.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Miratimi i Raportit financiar të tremujorit të parë (TMI) të vitit 2018;
3. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për transparencë;
4. Propozimvendimi për inicimin e binjakëzimit të kryeqytetit të Kosovës me kryeqytetin e "Des Moines" IOWA-së;
5. Propozimvendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);
6. Propozimvendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
7. Propozimvendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018;
8. Propozimvendimi për shitjen e pronës së luajtshme të Komunës;
9. Të ndryshme.

Njësori u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Agim Gashi tha se në faqen e 10-të të ekstraktit thuhet: "Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste në komunën e Prishtinës". Këtu nuk janë të përfshira vetëm veprimtaritë afariste, kështu që në Rregullore duhet të shtohet "... dhe veprimtarive të tjera në komunën e Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se njësori u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Miratimi i Raportit financiar të tremujorit të parë (TM1) të vitit 2018.

Sa i përket Raportit financiar të tremujorit të parë (TM1) të vitit 2018, **Valbona Makolli** tha se është përpjekur që në bazë të ligjit, t'i paraqes këto pika siç janë faktike, reale. Në investimet kapitale kemi një ngecje të madhe, mirëpo jam konsultuar me të gjithë drejtorët që kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratave, ku sipas tyre, ajo që ka ndikuar në rezultatin e ulët është ndërrimi i drejtorëve nëpër pozitat dhe koha jo e mirë, jo e përshtatshme për investime. Pra, këto janë arsyt që ndikuan në daljen e këtij rezultat në tremujorin e parë.

Halim Halimi tha se do të diskutojmë më gjerësisht në seancën e Kuvendit, por me sa vërejta, gjithnjë duke e krahasuar me vitin paraprak, edhe në të hyra, edhe në shpenzime kemi ngecje, marrë në tërësi edhe sipas drejtorive, ku kemi drejtorë që shpenzimet i kanë zero, zero dhe është fundi i muajit të katër. Nëse vazhdohet me këtë ritëm, është e vështirë të bëhet realizimi i buxhetit 2018. Ajo që më brengosi është çështja e të hyrave, që është e konstatuar se kemi ulje prej 11.96% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2017, kështu që në vend se të kemi progres në këtë drejtim, duke pasur parasysh prej vitit 2015, 2016 të shkojmë në progres të mbushjes së arkës së Komunës, të buxhetit, ne po shkojmë teposhtë. Kjo reflekton edhe në punën e drejtorive. Drejtoritë janë ato që duhet të ndikojnë në vjeljen e të hyrave për Komunë dhe të ndikojnë që të bëhen shpenzimet.

Të hyra më tepër kemi nga lejet e ndërtimit, pronësimi, shpronësimi, taksat për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike etj., do me thënë tek të gjitha këto kemi shënuar ulje në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar.

Agim Gashi kërkoi sqarime nga drejtoresha e Financave, se në formularin të cilin e ka për miratimin e buxhetit për vitin 2018, në të pasqyrohet se buxheti për vitin 2018 është miratuar 71,222,581 €, ndërsa në dokumentin në raportin financiar vjetor, në faqen 8, shpenzimet për

periudhën janar-mars 2018, dhe krahasimi me vitet paraprake në shtyllën e buxhetit për vitin 2018, është 72,273,904 €, mos është ky ndonjë gabim teknik.

Valbona Makolli tha se është gabim teknik dhe për seancë të Kuvendit do të përmirësohet në raport.

Agim Gashi theksoi se, duke marrë parasysh se këtë vit e kemi miratuar një buxhet mjaft solid, ne e dimë se burimet e rritjes së buxhetit janë llogaritur me mjetet nga mbeturinat dhe nga burimet tjera, ndoshta Ligji për Prishtinën, apo diçka tjetër nëse hyn në fuqi dhe e krijojnë këtë rritje, duke marrë parasysh se burimet e krijimit të të hyrave janë rritur, në këtë aspekt Komuna ka qenë e favorizuar, sepse e ka pasur blanko hyrjen e mjeteve nga mbeturinat. Nëse e krahasojmë këtë burim, shihet se në këtë tremujor Komuna ka dështuar plotësisht. Ndoshta gabimi më i madh është që janë bashkuar tre muaj, ndoshta kishte qenë më mirë të jetë muaj për muaj.

Çështje tjetër është se burimet kryesore kanë dështuar, burimet e të hyrave, si për shembull shfrytëzimi i sipërfaqeve publike, ku përqindja është më e vogël, ku gjatë gjithë dimrit i kanë shfrytëzuar sipërfaqet publike dhe janë rritur hapësirat e mëdha, por mjete nuk janë arkëtuar. Po ashtu, në këtë pasqyrë prapë nuk janë prezantuar raportet e ndërmarrjeve komunale. Kryetari i Komunës nuk e thotë asnjë fjali për ndërmarrjet komunale, kur ndërmarrjet komunale janë pronë e plotë e Komunës së Prishtinës.

Disa fjali këtu janë në kundërshtim me njëra-tjetrën, p.sh. në faqen 3, "Si rezultat i të hyrave vetanake të Komunës gjatë tremujorit, kanë shënuar ulje prej 11.96%". Ky është konstatim i pasqyrave dhe shumë real, ndërsa në faqen 7 thuhet "Realizimi i të hyrave është i kënaqshëm", tani nuk po kuptoj, sepse në fillim thotë ka ulje 11.96%, si mundet me qenë i kënaqëm kur ka ulje 12% krahasim me vitin paraprak. Te deklarata e Kryetarit thuhet: "Kryetari i Komunës vlerëson se realizimi i të hyrave vetanake në vitin 2018, është realizim i mirë dhe tejkalon realizimin paraprak të vitit 2017", mirëpo tash ka një burim të ri të të hyrave që atëherë nuk e ka pasur, andaj është mirë këto fjali me qenë komunikuese në mes veti, se kemi të bëjmë me një dokumente të rëndësishëm që pritet të votohet në Kuvendin e Komunës, andaj do të duhej të përmirësoheshin.

Valbona Makolli u shpreh se të gjitha sugjerimet, vërejtjet do t'i marrë parasysh dhe do t'i përmirësojmë aq sa ka mundësi, ndërsa sa i përket ndërmarrjeve komunale, në Bordin e Drejtorëve kam dashtë me i paraqitur si pikë, se e kam ngritur këtë çështje, mirëpo është konstatuar se ndërmarrjet komunale u përgjigjen vetëm aksionarëve që janë si asamblistë dhe si drejtorë që është i përfaqësuar, edhe atë vetëm një herë në vit. Ka qenë si pikë dhe e kam hequr.

Fatos Dibra dha sqarime, duke cekur se raportet financiare të ndërmarrjeve publike komunale, ligjërisht nuk mund të hyjnë në raportet buxhetore të Komunës, sepse nuk kanë të bëjnë me buxhetin e Komunës.

Vala Peshku kërkoi sqarime nga z. Agim Gashi, sepse nuk po kupton çka po kërkon për çështjen e ndërmarrjeve publike.

Agim Gashi tha se Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës duhet të kompletohet, ku me një, dy apo tri fjali shkruan se me miratimin e Kryetarit të Komunës, thotë diçka rreth ndërmarrjeve komunale të Komunës së Prishtinës, sepse janë vlerë shumë e madhe.

Fadil Gashi shprehu mendimin se në Komunën e Prishtinës nuk kemi asnjë ndërmarrje të suksesshme.

Genc Sherifi tha se nuk po e kuptoj z. Agim Gashi, por siç po duket asnjëri se kupton, kështu që nëse donë me diskutua rreth ndërmarrjeve, le të mban një seancë të jashtëzakonshme, po ja qesim nënshkrimet le ta thirr, t'i thërrasim aksionarët dhe të debatojmë për të, se Zyra ligjore po thotë se nuk mundemi me i futur në raportin financiar.

Fadil Gashi theksoi se nuk mund t'i thërrasim aksionarët, sepse janë shkarkuar aksionarët, është dashur në fillim, se katër muaj janë vonuar, e ndërmarrjet është dashur të japin raport.

Agim Kuleta, kryesues, tha se vërejtjet u dhanë, drejtoresha i morri ato dhe nëse e sheh të arsyeshme i inkorporon.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Raporti financiar i tremujorit të parë (TM1) të vitit 2018 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tretë

Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për transparencë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për transparencë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërt

Propozimvendimi për iniciimin e binjakëzimit të kryeqytetit të Kosovës me kryeqytetin e "Des Moines" IOWA-së;

Osman Bllaca dha sqarime, duke cekur se ata e kanë dërguar një kërkesë në lidhje me këto, ku Komunitat kanë të drejtë të bëjnë binjakëzimin, kjo është vetëm një iniciativë, ne vetëm një takim e kemi mbajtur me ta. Në marrëveshje të binjakëzimit përcaktohen të gjitha fushat ku dëshirojmë ne të bëjmë bashkëpunim me ta dhe në cilat fusha mund të bashkëpunojmë.

Agim Gashi pyeti se Vendimi a është formuluar drejt, kur dihet se Komuna e Prishtinës ka zhvilluar bashkëpunim ndërkombëtar edhe më herët, këtu po thotë "për iniciimin", që nënkupton se sot po ja fillon për herë të parë.

Agim Kuleta, kryesues, theksoi se Vendimi është i drejt, vetëm për këtë bashkëpunim për rastin konkret.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për iniciimin e binjakëzimit të kryeqytetit të Kosovës me kryeqytetin e "Des Moines" IOWA-së dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Osman Bllaca dha sqarime, duke cekur se sipas Rregullores së punës është e paraparë të caktohen 9 anëtarë, ashtu siç janë edhe komitete tjera. Këtu dy janë prej komuniteteve, janë përfaqësues të përcaktuar sipas Rregullores, siç janë serb, turq, boshnjak dhe komiteteve që i kemi në komunën tonë, duhet të përcaktohen edhe 7 anëtarë të Kuvendit komunal, që i bie prej 42 anëtarëve sa duhet të përfshihen të të gjitha subjekteve të Komunës. Ne duhet, me gjithë shefat e grupeve të Kuvendit, ta gjejmë një formulë të përbashkët, që në mënyrë proporcionale me qenë të gjitha subjektet e përfaqësuara në mënyrën e duhur.

Vala Peshku tha se në disa komitete i kemi nga 8 vende të lira e jo 7, si në Komitetin për Arsim, Kulturë dhe Sport, në Komitetin për Planifikim Urbanë, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Osman Bllaca tha ka mundësi nuk i ka sjellë komuniteti aktual.

Agim Gashi pyeti se si është e mundur që në secilin komitet të ketë përfaqësues të komunitetit turk ose serb.

Fatos Dibra tha se në Rregulloren për përbërje dhe kompetencat e komiteteve sqarohet përcaktimi i komiteteve tjera, ku për secilin komitet thotë se ky proporcion i pakicave duhet të jetë dy përfaqësues të pakicave.

Halim Halimi tha se Rregullorja parasheh dy përfaqësues nga pakicat, mirëpo, ne nuk kemi në Kuvendin nga pakicat as serb, as turq, por pasi që është në Rregullore duhet ta zbatojmë.

Agim Kuleta, kryesues, theksoi se duhet shikuar a e parasheh Rregullorja një përfaqësues nga Kuvendi dhe një jashtë Kuvendit të Komunës. Nëse është një nga Kuvendi, atëherë bie një.

Fatos Dibra dha sqarime, duke thënë se në Rregullore thuhet me qenë dy nga pakicat dhe nuk e definojnë a duhet me qenë brenda Kuvendit apo i jashtëm.

Sami Boroci pyeti se a kompensohen pjesëmarrësit që janë jashtë Kuvendit.

Agim Kuleta, kryesues tha se nuk paguhen asnjë, të brendshmit as të jashtëmit.

Halim Halimi bëri të ditur se edhe në të kaluarën komitetet jo obligative shumë pak kanë funksionuar për shkak të mos pagesës, por ne duhet ta kryejmë anën tonë ligjore, t'i formojmë Komitetet dhe ta zbatojmë rregulloren. Kur është hartuar vendimi, është dashur të zërthehej formula se sa i takojnë LDK-së, PDK-së etj., e detyrë e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit, është me i caktuar emrat sipas partive politike.

Agim Kuleta, kryesues, theksoi se këtu diskutohet çështja e formulës, ose e mendojmë dhe e dërgojmë si formulë me E-mail shefave të GP-ve, t'i mendojmë emrat për seancën e radhës, ose i thërrasim shefat e GP-ve dhe diskutojmë atje.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018.

Agim Gashi tha se në muajin mars nuk e keni riformuluar ndërrimin e pronës, por i keni kopjuar fjalët prej rendit të mbledhjes së Kuvendit, po ashtu edhe një muaj tjetër ishte e fuzionuar, nuk ka qenë, por duhet me thënë "... këmbimi i pronave sipas kërkuesve dhe propozimit të drejtorive përkatëse", sepse ajo po i bie që kemi kopjuar. Po ashtu, Drejtoria e Bujqësisë, sipas këtij plani, është plotësisht pasive, nuk informon kurrë asgjë në Kuvend.

Osman Bllaca dha sqarime, duke thënë se janë: Informata për mbjelljet pranverore dhe Informata për përgatitjen e korrje-shirjeve 2018, mirëpo nëse dëshironi një informatë të përgjithshme, caktone një muaj dhe e paraqesim.

Halim Halimi theksoi se është mirë që në këtë Plan vjetor të punës të mos anashkalohen ndërmarrjet publike lokale, të ketë një informatë për punën e NPL-ve, se edhe ato janë pjesë e Komunës së Prishtinës.

Po ashtu, në pjesën e muajit shtator, është një përsëritje të Arsimit, Informatë për fillimin e vitit shkollor 2018/2019 dhe për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018, të mbetet pika e tretë, përsëritet, andaj të hiqet "Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019".

Agim Gashi tha se në muajin dhjetor parashihet të jetë "Informata mbi punën e komiteteve dhe komisioneve të Kuvendit", kjo të zërthehet, t'i shtohet "komisioneve aksionare të ndërmarrjeve publike lokale", sepse mund të mos kuptohet drejt.

Jonuz Salihaj kërkoi që në muajin qershor të jetë Informata për përfundimin e vitit mësimor - suksesi.

Osman Bllaca dha sqarime, duke thënë se në muajin korrik është Informata për përfundimin e gjysmëvjetorit të vitit shkollor 2017/2018, testit të arritshmërisë dhe testit të maturës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Propozimvendimi për shitjen e pronës së luajtshme të Komunës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për shitjen e pronës së luajtshme të Komunës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Të ndryshme.

Sami Boroci shtroi pyetjen lidhur me fatin e asamblastëve, të këshilltarëve komunalë, duke thënë se a ka dërguar Komuna ndonjë shkresë zyrtare, se personalisht konsideroj që kompensimi dhe krahasimi i Komunës së Prishtinës me një komunë të vogël të Kosovës, si për shembull Komuna e Klllokotit, nuk është korrekte, është dashtë të rishikohet kjo pjesë. Ai tha se kam një hall si asamblast, po më duket që vetëqeverisja dëshiron me i mbajtur asamblastët pak më qetë dhe më pak të interesuar për punën e Komunës, nuk jam në dijeni, andaj po më intereson se a ka shkuar ndonjë shkresë zyrtare qoftë prej Kryetarit, qoftë prej juve apo dikujt tjetër në Komunë, që kjo të parashihet të bëhet pjesë e ligjit.

Agim Kuleta, kryesues, tha ne në mbledhjen e kaluar me Grupin punues për planin e punës, u pajtuam që të mblidhemi, ndoshta iniciativë e vetë Kuvendit, të mblidhen shefat e grupeve edhe një herë, që janë të interesuar të kontribuojnë në këtë drejtim ta ndërtojmë një strategji. Unë po e marr për sipër t'i bëjmë disa takime me Ministrinë e Financave apo dikë tjetër, për të parë se si duhet ndjekur këtë punë se është shqetësuese.

Sami Boroci tha se Prishtina do të duhej të kishte status të veçantë, ishte dashur që edhe drejtorët dhe asamblastët me këtë rast të kenë status të veçantë. Përveç që e kishte rritur kjo cilësinë e qeverisjes dhe llogaridhënien, secili prej nesh e kishte marrë këtë më seriozisht.

Agim Kuleta, kryesues, shprehu mendimin se duhet një konsultim ligjor në këtë drejtim. Ai u shpreh i gatshëm ta marrë për sipër një takim me Ministrinë e Financave, për të parë se cilat janë mundësitë dhe cilat ligje të ndryshohen, në mënyrë që të ndryshohet statusi, të ndryshohet për të mirë, dhe mund të jetë iniciativë vetëm me deputetët për ta shtyrë përpara këtë punë, të amandamentohet me ligje të caktuara.

Agim Gashi tha se trajtimi i komiteteve jo obligative më shumë i takon si kompetencë Komunës, pra Komuna është më kompetente në këtë punë. Ajo që nuk mund të na pengojë askush, është trajtimi i komiteteve. Edhe pse janë jo obligative dhe janë pa pagesë, unë e di se ka njëfarë tolerance në mes të nivelit qendror dhe nivelit lokal dhe ka njëfarë hapësire vakumi ligjor, ku komitetet mundën me u paguar me një vlerë të kufizuar nëse ka vullnet brenda qeverisë komunale dhe Kuvendit.

Halim Halimi tha se ka komuna që i paguajnë komitetet jo obligative, por ata i rrinë gati më herët me rastin e hartimit të buxhetit. Ne jemi përpjekur në vitin e kaluar me Demosin, që të mundësohet pagesa për katër mbledhje gjatë vitit, por nuk ka qenë vullneti, se ka pasur mundësi nëse në fillim është paraparë në buxhet, por nëse nuk është paraparë në buxhet nuk mund të bëjmë asgjë. Besoj që vetëm Ligji për Prishtinën mund të bëj ndryshim, Komuna e Prishtinës si kryeqytet është çështje specifike dhe në bazë të saj mund të fitojmë diçka, përndryshe, me ligjet ekzistuese të gjitha komunat janë të barabarta, por nuk është në rregull të barazohet kryeqyteti, me komunat, si Fushë-Kosova, Dragashi etj., por kjo është përcjellë deri tash. Do të ishte mirë për anëtarët e Kuvendit me pasur një sallë, zyrë, së paku ndonjë materiale me lënë etj. Është e vërtetë, ne e kemi pasur sallën e komiteteve që e kemi shfrytëzuar.

Osman Bllaca dha sqarime lidhur me rritjen e pagave, po ashtu tha se sa i përket pagesës së komiteteve tjera, ka Komuna të cilat i paguajnë komitetet e tjera, por çdo komunë që e bënë pagesën e komiteteve tjera bënë shkelje ligjore, është neni 80 i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, ku saktë e citon që nuk mund të paguhet asnjë anëtar i komiteteve tjera, me përjashtim të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete. Unë e kam shkresën e ministrit Abdullah Hoti, që na e ka sjellë në vitin 2015, se asnjë pagesë nuk mund të bëhet.

Agim Gashi tha se ne duhet harmonizuar, me pasur kujdes, kemi shumë ligje që nuk janë harmonizuar mes vete, ato mbesin në letër, janë të pazbatueshme.

Mbledhja përfundoi në orën 11:05.

Procesmbajtësja
Shyhrete Islami



Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta